

VENDIM
Nr.630, datë 24.12.1999

**PËR NJË SHITESË NË PLANIN E BUXHETIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR
VITIN 1999**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 29, të ligjit 8379, datë 29.7.1998, “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Aparatit të Këshillit të Ministrave, në buxhetin e miratuar për investime për vitin 1999, i shtohen 66 milionë lekë, për blerjen me procedurën e prokurimit të drejtpërdrejtë të 1 autoveture tip “mercedes Benz” S 600 blindato dhe të tre automjete tip “Mercedes Benz” S 320, me shoqërinë ASA-Auto Star Albania.

2.Shuma prej 66 milionë lekësh të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3.Ngarkohen Ministria e Financave dhe aparati i Këshillit të Ministrave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta